



Projekti i Binjakëzimit i financuar nga BE

Rritja e mëtejme e ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit e Kosovës
KS 17 IPA FI 01 19

Në zbatim nga Institucioni Suprem i Auditimit i Polonisë në ZKA e Kosovës

kërkon të punësojë staf për 1 pozitë:

RSB Asistent i KRB / Asistent gjuhësor i KRB

Kohëzgjatja: deri me 28 shkurt 2021, me mundësi vazhdimi deri me 31 maj 2021.

Vendndodhja: Zyra Kombetare e Auditimit e Kosoves në Prishtinë

Paga mujore bruto dhe gjithëpërfshirëse për punë me orar të plotë: €1.500/muaj

Detyrat:

- Vepron si asistent kryesor i KRB dhe për ekspertët në vizitë
- Përkthen me shkrim dhe simultan nga gjuha shqip-anglisht/anglisht-shqip kur është e nevojshme
 - Përkthen materiale me shkrim shqip/anglisht dhe anasjelltas
 - Përkthen simultan shqip/anglisht dhe anasjelltas gjatë misionëve, takimeve, punëtorive, seminareve, trajnimeve dhe ngjarjeve të tjera të projektit (edhe jashtë Kosovës);
- Ndihmon KRB-në me menaxhimin dhe koordinimin e projektit, përfshirë menaxhimin e përgjithshëm të administratës së zyrës, mbajtjen e shënimeve të projektit, punë të përgjithshme të zyrës, rezervimin dhe organizimin e trajnimeve, misionëve të ekspertëve, udhëtimet brenda vendit, takimet me komitetin drejtues, mbajtjen e procesverbalit kur është e nevojshme, mirëmbajtjen e inventarit dhe materialit për zyrë, me kontabilitetin e buxhetit etj.
- Harton materiale me shkrim, raporte, etj. në gjuhën shqipe dhe angleze
- Krijon dhe ruan kontakte dhe marrëdhënie me zyrtarë të institucioneve partnere, median etj.
- Kryen detyra të tjera që i caktohen
- Ruan një nivel të lartë të etikës



- Ruan konfidencialitetin në të gjitha çështjet lidhur me realizimin dhe menaxhimin e projektit

Kërkesat dhe shkathtësitë e detyrueshme:

- Zotërim i shkëlqyeshëm i gjuhës angleze dhe shqipe në të shkruar dhe të folur
- Shkathtësi organizative, administrative dhe menaxheriale dhe aftësi për të identifikuar prioritetet, përmbushur afatet, zbatuar risitë dhe për tu adaptuar me rrethanat në ndryshim
- Shkathtësi të forta ndër-njerëzore dhe komunikuese
- Përvojë pune në mjedis ndërkombëtar, veçanërisht si asistent në ndonjë projekt tjetër ndërkombëtar në Kosovë
- Aftësi shumë të mira për hartimin e raportit në gjuhën angleze
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e MS Office (Microsoft Word, Excel, PowerPoint)
- Përvojë në përkthimin me shkrim dhe simultan nga anglisht në shqip dhe anasjelltas (gjatë takimeve, punëtorive, përkthimin e dokumenteve)
- Fleksibilitet lidhur me orarin e punës
- Diplomë universiteti
- Asistenti/Asistenti gjuhësor i KRB nuk duhet të ketë pasur marrëdhënie kontraktuale me administratën përfituese në gjashtë muajt e fundit.

Përvojë dhe shkathtësi të tjera:

- Përvoja në përkthime simultane do të ishte një aset
- Zotërimi i gjuhës serbe do të ishte një aset

Procedura e përzgjedhjes::

Kandidatëve të interesuar iu kërkohet të dorëzojnë:

- CV (në anglisht, formati Europass)

Deri me **26 Janar 2021** në anglisht përmes postës elektronike (ju lutem e cekni "RTA Assistant") tek: assistant.recruitment2021@gmail.com

Kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen përmes postës elektronike për një intervistë.